



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

---

Numri i lëndës: 2019:234460

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06432000

C.nr.624/19

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rruga "... OB-2, Lagja ..., të cilën me autorizim e përfaqëson V.V, kundër të paditurit L.Z nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti rimbursim dëmi, me vlerë të kontestit 14,289.57 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor e publik me datë 30.10.2024, në prezencën e të autorizuarit të paditëses e në mungesë të të paditurit, me datë 11.11.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rruga "... OB-2, Lagja ...

II. DETYROHET i padituri L.Z nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, që në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit të datës 07.01.2018, paditëses Kompania e Sigurimeve "...", t'ia paguaj shumën prej 14,289.57 € (katërmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë e shtatë cent) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga paraqitja e padisë (03.09.2019) e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 100.00 euro, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Paditësja Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, rruga "... OB-2, Lagja ..., përmes të autorizuarit të tij, me datë 03.09.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurit L.Z nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, për rimbursimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti komunikacionit të datës 07.01.2018, në shumën prej 14,289.57 € (katërmëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë e shtatë cent) në emër të dëmit material, përfshirë kamatën dhe shpenzimet e procedurës. Ka shtuar se për dëmin e shkaktuar nga i padituri, të dëmtuarit Kompania e Sigurimeve H. C me seli në Gjermani, ia ka paguar shumën prej 13,889.57 euro ndërsa të dëmtuarit "D..." SH.P.K nga Vushtrria, ia ka paguar shumën prej 400.00 euro, dhe në bazë të Ligjit nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, ka kërkuar rimbursimin e dëmit nga shkaktari i aksidentit-këtu i padituri në shumën prej 14,289.57 euro, me kamatë ligjore nga paraqitja e padisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës.

I padituri përmes përgjigjes në padi të parashtruar më datë 10.10.2024, fillimisht e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia.

Në seancën përgatitore të mbajtur më datë 15.10.2024, përfaqësuesja e paditëses ka mbetur pranë kërkesëpadisë, duke shtuar se aksidenti i komunikacionit i datës 07.01.2018 është shkaktuar me lëshimet e të paditurit dhe ky fakt vërtetohet nga raporti i policisë, pra vërtetohet përgjegjësia e të paditurit për rimbursim të shumës së paguar dhe se i padituri në ditën e aksidentit nuk ka poseduar patentë shofer, e çka të njëjtin e bën përgjegjës për rimbursim të dëmit të paguar nga kompania e sigurimeve, bazuar në LSDA. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, në bazë të provave të cilat i janë bashkangjitur padisë, vërtetohet saktë dhe pa asnjë dilemë se shumata të cilën paditësja ia ka paguar të dëmtuarve është reale në raport me dëmet e shkaktuara nga aksidenti. Andaj gjykatës i ka propozuar të aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses. Palës së paditur i ka ofruar mundësi që kontestin ta zgjidhin me marrëveshje ashtu që të paguajë shumën prej 12.000 euro, me këste mujore në shumën prej 120 euro.

I padituri nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe ka pranuar se ka qenë shkaktar i aksidentit por e ka kundërshtuar lartësinë e saj, përkatësisht shumën e kërkuar nga paditësja, për shkak se e njëjta është e lartë dhe nuk ka mundësi financiare që ta paguaj, qoftë edhe me këste prej 120 euro në muaj. Nga gjykata kishte kërkuar shtyrjen e seancës me qëllim që të angazhoj një avokat.

Gjykata me datë 30.10.2024, ka mbajtur seancën e radhës në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e paditëses, ndërsa ka munguar i padituri, përkundër thirrjes së rregullt.

Përfaqësuesja e paditëses ka mbetur pranë kërkesëpadisë dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se aksidenti i komunikacionit është shkaktuar me lëshimet e tani të paditurit, e i cili në ditën kritike nuk ka poseduar patentë shofer, me çka ka humbur mbulesën siguruese andaj, të njëjtin e bën përgjegjës për kompensimin respektivisht rimbursimin e dëmit personave të dëmtuar nga ky aksident, e të cilin paditësja ia ka kompensuar dëmin si në provat e bashkangjitura si në kërkesëpadi, personave të dëmtuar dhe atë vozitësit të automjetit B dhe automjetit C, të cilët kanë pësuar dëm material në veturat e tyre. Bazë ligjore për rimbursimin e dëmit të cilin paditësja ua ka kompensuar të dëmtuarve nga ky aksident, buron nga LSDA, ndërsa lartësia e kërkesëpadisë po ashtu është vërtetuar nga provat e bashkangjitura si në kërkesëpadi, si dhe dëshmime të fletëpagesave. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar, duke detyruar të paditurin që të paguajë vlerën e dëmit në shumë prej 14,289.57 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e ngritjes së kësaj padie, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të taksës për padi shumën prej 100 euro.

Gjykata, për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykatë me datë 03.04.2024, bëri administrimin e provave dhe atë: raporti policor me numër 2018-BR-018 të datës 07.01.2018, me skicën e bashkangjitur, padia e Kompanisë së Sigurimeve H.C me seli në Gjermani, e datës 28.12.2018, Polica e sigurimit në gjuhën gjermane e përkthyer në gjuhën shqipe, Dokumenti mbi kompensimin e dëmit i datës 09.02.2018, Dokumenti mbi kompensimin e dëmit i datës 05.02.2018, Fotot e veturës së aksidentuar, Komunikimi elektronik i datës 16.03.2018, 06.07.2018, Njoftimi i datës 17.07.2018, Ujdia jashtëgjyqësore e datës 30.07.2019, Ekspertiza-vlerësimi i dëmit në automjet, e datës 18.06.2019, Transferi i pagesës i datës 19.08.2019, Ujdia jashtëgjyqësore e datës 13.02.2018, Procesverbali mbi dëmin e automjetit i datës 18.01.2018, Leja e qarkullimit në emër të të dëmtuarit P.Q.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga këto arsye:

Nuk ishte kontestuese se me datë 07.01.2018 në fshatin ... Komuna e Vushtrrisë ishte shkaktuar aksident i komunikacionit në të cilin ishte i përfshirë i padituri L.Z, i cili ishte pa mbulesë siguruese në momentin e shkakimit të aksidentit, sepse nuk kishte patent shofer, e në bazë të raportit policor konstatohet se i padituri me veprimin e pasigurt në komunikacion-kthim në të majtë dhe në vijë të plotë, e godet automjetin B, të cilin e drejtonte P.Ç. i siguruar në Kompaninë e Sigurimeve H. C me seli në Gjermani, e i cili humb kontrollin dhe godet automjetin C me pronar "D..." SH.P.K nga Vushtrria, i cili ishte i parkuar jashtë rrugës.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësja dhe e dëmtuara Kompania e Sigurimeve H. C me seli në Gjermani, me datë 30.07.2019, kishin lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e të gjitha formave të dëmit, në shumën prej 13,889.57 euro, e paguar nga paditësja me transferin e datës 19.08.2019. Kurse me datë paditësja dhe i dëmtuari i dytë "D..." SH.P.K nga Vushtrria, kishin ujdia jashtëgjyqësore, për kompensimin e dëmit në shumën prej 400.00 euro, e cila shumë ishte paguar nga paditësja me transferin e datës 28.02.2018.

Nuk ishte kontestuese as baza juridike e kërkesëpadisë, pasi që i padituri, si është theksuar më lartë e ka pranuar se ka qenë shkaktar i aksidentit, por e ka kundërshtuar lartësinë e saj, për shkak se e njëjta është e lartë dhe se nuk ka mundësi financiare që ta paguaj, qoftë edhe me këste. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë se paditëses, gjykata u bazua në Ekspertizën- vlerësimin e dëmit në automjet, e datës 18.06.2019.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se i padituri mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar dhe se paditësja ka të drejtë të kërkoj rimbursimin-regresin e dëmit nga i padituri, përkatësisht themelësia e kërkesëpadisë së paditëses del nga dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/1-018, përkatësisht neni 14 par.1, pika 1.2 i cili përcakton se *"I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur: (1.2) drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimave të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimin;"* e lidhur me paragrafin 3 të këtij neni i cili përcakton se: *"Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese."*

Tutje, neni 136 par.1 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcakton se *"Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është*

*shkaktuar pa fajin e tij.*”, ndërsa neni 960 par.1 i këtij ligji përcakton se “*Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin.* Andaj bazuar në këto dispozita ligjore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë si nga ana faktike ashtu edhe nga ana juridike dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata, lidhur me kamatën ligjore u bazua në nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 dhe Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020 të datës 02.12.2020.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u bazua në dispozitat e nenit 452 par.1 të LPK-së, të cilat i referohen taksës gjyqësore për padi në shumën prej 100.00 euro.

Mbi bazën e të lartcekurave, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.624/19, me datë 11.11.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.